


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

NR. 351 AKTI

NR 5776 VENDIMI

VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej:

REGLETA PANAJOTI-	GJYQTARE
MARIANA (DEDI) SHEGANI-	GJYQTARE
BRIKENA LUBONJA-	GJYQTARE

Asistuar prej sekretares Elona Alvora, sot me dt 20.07.2007 mbaroi se shqyrtuari ne séance gjyqesore publike ceshtjen civile me:

KERKUES:

Dega e Tatimpaguesve te Medhenj Tirane perfaquesuar ne gjykim nga znj O.Cevi e E.Kocani ne baze te autorizimit te leshuar me dt 01.02.2006 me nr 7962/3 prot, si dhe autorizimit te leshuar nga Avokatura e Shtetit nr extra prot dt 13.04.2006.

PERSON I TRETE:

Shoqeria tregtare “HAWAI-ALB” shpk regjistruar si person juridik me vendimin nr 16807 dt 28.01.1997, me seli Rr. Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, Qendra e biznesit “Veve Center”, Tirane, me administrator z. Elsayed Metwalli Abdelrahman, perfaquesuar ne gjykim ne baze te prokures nr 2039/1719, dt 04.03.2006 nga Av.N.Fana (**ne mungese**).

OBJEKTI: Celja e procedures se falimentimit per shoqerine tregtare "HAWAI-ALB" shpk.

BAZA LIGJORE: Ligji nr 9801 dt 23.05.2002 "Per falimentimin" nenı 13, 14 I tij.
Ligji nr 8560 dt 22.12.1999 "Per procedurat tatimore", nenı 46 I tij.

Gjykata si e bisedoi ceshtjen ne teresine e saj

VEREN

Se prane kesaj Gjykate ka ardhur per shqyrtim kerkesa me objekt te siperpermendur.

Shoqeria tregtare "HAWAI ALB" shpk eshte rregistruar si person juridik me vendimin nr 16807 dt 28.01.1997 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tiranë. Ajo ka si administrator ortakun e vetem te saj shtetasin egjiptjan z. Elsayed Metwalli Abdelrahman.

Me kerkesen objekt shqyrtimi te kesaj Gjykate, Dega e Tatimpaguesve te Medhenj kerkon te çelet procedura e falimentimit per kete shoqeri tregtare pasi ajo rezulton debitore sipas njoftimeve te vleresimeve tatimore dhe akt kontolleve, detyrim I cili ne total kap vleren 90.918.696 leke, shume e cila ndryshon ne rritje per shkak te llogaritjes se interesave persa kohe qe detyrimi mabetet pa paguar.

Gjykata cmoi dhe thirri me cilesine e personit te trete ne gjykim konform nenit 193 te K. Pr. Civile si dhe nenit 10 te ligjit nr 8901 dt 23.05.2002, shoqerine tregtare "Hawai Alb" shpk, per te cilen kerkohet te celet procedura e falimentimit.

Gjykata perfundoj gjykin pjeserisht ne mungese te personit te trete, megjithese shoqeria dhe perfaquesuesi u njoftuan rregullisht per te gjitha seancat gjyqesore konform Kodit te Procedures Civile.

Para shqyrtimit te bazueshmerise ne prova dhe ne ligj te kerkeses se mesiperme, Gjykata fillimisht analizoi juridikacionin dhe kompetencen e saj per gjykin e kesaj çeshtjeje.

Sipas nenit 36 te K. Pr. Civile ne juridikacionin e gjykatave hyjne te gjitha mosmarreveshjet civile e mosmarreveshjet e tjera te parashikuara ne kete Kod dhe **ne ligje te veçanta**.

Ligji Nr. 8901, date 23.05.2002 «Per Falimentimin» eshte nje ligj i vecante, qe synon sigurimin e nje mekanizmi te pershtatshem per

riorganizimin ose likuidimin e nje personi fizik ose juridik qe ndodhet ne veshtiresi financiare. Per te realizuar kete mision, ne nenin 3 te ketij ligji parashikohet:

“Realizimi i procedurave te falimentimit eshte detyre e seksioneve te gjykates se rrerhit. (gjykata e falimentimit)“

Nga analiza e kesaj dispozite rezulton se realizimi i procedures se falimentimit i perket juridiksonit gjyqesor dhe se kompetencen lendore per te gjykuar ne kete rast e ka seksioni tregtar prane gjykates se rrerhit gjyqesor perkates. Nje parashikim i tille perputhet edhe me nenin 334/dh te K. Pr. Civile qe parashikon:

“Ne kompetence te seksioneve per gjykin e mosmarreveshjeve tregtare prane gjykatave te shkalles se pare jane :

a)...

dh) procedurat e falimentimit.“

Ne vazhdim, ne nenin 4 te ligjit “Per Falimentimin”, parashikohet se pergjegjesia territoriale e Gjykates se Falimentimit do te percaktohet ne baze te venndodhjes se selise, kur debitori eshte person juridik, ose te vendbanimit te debitorit kur ai eshte person fizik.

Ne kerkesen per gjykim kerkohet hapja e procedures se falimentimit per shoqerine tregtare «Hawai Alb» shpk, e cila sipas vendimit te regjistrimit dhe praktikes tregtare te terhequr, rezulton me seli te fundit ne, Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, Qendra e Biznesit “Veve Center”, Tirane. Rrjedhimisht kompetanca tokesore ne shqyrtimin e kerkeses i perket Seksionit Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ka rezultuar gjate gjykit se:

Shoqueria tregtare “Hawai Alb” shpk ka formen e personit juridik shoperi me pergjegjesi te kufizuar rregjistruar si person juridik me vendimi nr 16807 dt 28.01.1997 me seli ne Tirane dhe ortak te vetem e administrator shtetasin egjiptjan Elsayed Metwalli Abdelrahman. Kohezgjatja e aktivitetit te kesaj shoquerie eshte 25 vjet dhe ka si objekt kryesor te aktivitetit te saj import-eksport mallrash, investime ne fusha te ndryshme si ate te ndertimeve publike, te godinave te banimit, te infrastruktures, ne blerje e shitje trojesh dhe dhenie me qira e tyre dhe te ndertesave; investime ne fushen e turizmit si aktivitete turistike, celje restorantesh dhe hotelesh, camping dhe fshatra turistike, axhensi turistike; investime ne fushen e transportit si transportin detar, automobilistik, ajror; ndertime civile, sociale dhe ekonomike, ndertim

rrugesh, ujesjelles e kanalizime, sipermarrje; prodhim dhe tregtim materialesh inerte, me kapital fillestar 108.600 leke.

Me kerkesen e paraqitur perpara kesaj gjykate kerkuesi Dega e Tatimpaguesve te Medhenj Tirane pretendoi se:

1-Shoqeria tregtare "Hawai Alb" shpk nuk ka paguar detyrimet tatimore qe kane lindur nga kontrolllet e ushtruara ndaj saj. Keto detyrime kane lindur sipas njoftim vleresimeve tatimore, njoftim tatimfitimi paraprak, gjoba te te papaguara per TVSH, detyrim te papaguara te TVSH etj te cilat u depozituan bashkangjitur me kerkesen objekt shqyrtimi gjyqesor te kesaj Gjykate. Ne kuadrin e provave u paraqiten nje sere dokumentash financiare te natyres njoftim vleresimi tatimor, njoftim tatimi fitimi e me konkretisht keto detyrime burojne nga:

a- njoftim vleresimi tatimor nr 264/31 dt 25.04.2002 ne baze te te cilit rezulton se shoqeria nuk ka paguar detyrimin brenda afatit te parashikuar ne ligj

b-njoftim vleresimi tatimor nr 991/6 dt 05.07.2004 nuk ka paguar detyrimin (detyrim + gjobe + interesa per mospagim ne kohe).

c- Gjoba per TVSH, detyrim i lindur nga mosdorezimi ne afat i formularit te deklarimit te pagesave te TVSH

d- Tatim fitimi paraprak per vitin 2002, 2004, 2005 etj.

Ne total detyrimi kap vleren monetare 90.918.696 Leke

2 -Kjo pale mbasi nuk ka bere te mundur vjeljen e detyrimit ne rruge administrative i eshte drejtuar Gjykates me kerkesen objekt te ketij shqyrtimi gjyqesor.

Ligji «Per Falimentimin», i jep te drejte Gjykates se Falimentimit, te hetoje kryesisht per te gjitha rrethanat qe kane lidhje me nje procedure falimentimi (neni 6 i Ligjit). Ne ndryshim nga roli i saj ne nje proces gjyqesor civil normal, i cili eshte kryesisht pasiv, gjate gjithe ketij gjykimi, ne zbatim te parimit te mesiperm dhe ne funksion te mbikqyrjes dhe administrimit te procedures se falimentimit, kjo Gjykate luajti nje rol aktiv ne hetimin gjyqesor dhe marrjen e te gjitha vendimeve te ndermjetme.

Ne zbatim te nenit 16 te K.Pr.Civile dhe te parimit te rolit aktiv te saj ne nje proces falimentimi gjykata shtroi per zgjidhje keto ceshtje:

1. A legitimohet Dega e Tatimpaguesve te Medhenj per te kerkuar celjen e procedures se falimentimit ndaj shoqerise debitore «Hawai Alb» shpk?

Ne interpretim te dispozitave te posaçme te Ligjit «Per Falimentimin», organet tatimore mund te kerkojne hapjen e nje procedure falimentimi ne dy raste (neni 14) :

1. Per shkak se nje e drejte e tille iu njihet shprehimisht ne ligj, ose
2. Per shkak te cilesise se tyre si kreditore.

Ne rastin e pare, organi tatimor pa e provuar qe eshte kreditor, mund te kerkaje hapjen e procedures se falimentimit vetem ndaj nje personi juridik, mjafton qe shoqeria te kete paraqitur nje bilanc me humbje per nje periudhe 3-vjecare. Ne mungese te vete bilancit si nje kerkese e domosdoshme ligjore, Dega e Tatimpaguesve nuk te mund legjitimohet per te kerkuar hapjen e procedures se falimentimit.

Ne rastin e dyte, kur organet tatimore edhe pse kane perm bushur te gjitha procedurat e parashikuara ne ligjin tatimor, por perseri nuk kane mundur te vjelin detyrimin, ato marrin cilesine e kreditoret, ashtu si te gjithe kreditoret e tjere per detyrime te pavjela prej tyre (neni 14, 16/1 i ligjit). Nje parashikim te tille e gjejme edhe ne ligjin Nr. 8560, date 22.12.1999 «Per Procedurat Tatimore», i cili ne nenin 46/c te tij me titullin «Procedurat e jashtezakonshme te mbledhjes me force te detyrimeve», parashikon:

“...Nese tatimpaguesi nuk mund te paguaje, organi tatimor kerkon fillimin e procedurave te falimentimit si kreditor i interesuar, ne mbeshtetje te Ligjit nr.8901, date 23.05.2002 «Per Falimentimin».

Nga te gjitha provat e marra ne gjykim, rezulton se shoqeria “Hawai Alb” shpk eshte debitore ndaj Deges se Tatimpaguesve te Medhenj ne shumen prej 90.918.696 lekesh. Pamundesa e vjeljes se kredise nga ana e kerkuesit, me gjithe respektimin e dispozitave te ligjit tatimor, e kane detyruar ate qe ne pamundesi te nje ekzekutimi individual te detyrimit nga debitori shoqeria «Hawai Alb», t'i drejtohet gjykates duke kerkuar hapjen e procedures se falimentimit ndaj shoqerise debitore, per te perfituar nga ekzekutimi i per gjithhem qe perfshin te gjithe pasurine e debitorit.

“Nisur nga arsyetimi i bere me lart Gjykata e falimentimit konkludon se Dega e Tatimpaguesve te Medhenj ka nje interes te ligjshem per hapjen e kesaj procedure falimentimi.”

Kerkesa e Deges se Tatimpaguesve te Medhenj permban te gjitha pretendimet dhe provat e nevojshme ne mbeshtetje te tyre, per mosperm bushje te detyrimeve nga ana e debitorit, shoqeria “Hawai Alb” shpk, te cilat jane permendur me siper ne vendim, sipas nje rendi kronologjik, ne pjesen e

paraqitjes se fakteve sic kane rezultuar gjate gjykimit. Gjithashtu debitori per te cilin kerkohet hapja e procedures se falimentimit nuk pershihet ne listen e subjekteve te parashikuara ne ligj, per pasurine e te cileve nuk mund te hapet procedura e falimentimit (neni 12 i ligjit).

Interesi i ligjshem i kerkuesit Dega e Tatimpaguesve te Medhenj ne kete gjykim nuk mjafton per ta legjitimuar si kreditor qe mund te kerkoje hapjen e nje procedure falimentimi, pasi kerkesa e kreditorit duhet te kete edhe nje shkak. Keshtu neni 17 i Ligjit parashikon:

"Kerkesa e kreditorit pranohet nga seksioni tregtar i gjykates se rrethit, kur ai ka nje interes te ligjshem per hapjen e procedures se falimentimit, kur paraqet kerkesen sipas ligjit dhe nese gjykata cmon se shkaqet per hapjen e procedures se falimentimit jane te mjaftueshme dhe bindese. Shkaku per hapjen e procedures se falimentimit prezumohet se ekziston nese debitori, pavaresisht se nuk e ka kundeshtuar pretendimin, nuk e ka shlyer kete detyrim tre muaj pas dates se maturimit."

Nga interpretimi i dispozites me lart rezulton se kerkuesi ne gjykim per tu legjitimuar, duhet te provoje se ka me shume se tre muaj qe nje detyrim i maturuar, i pakundeshtuar nga debitori nuk eshte permbushur prej tij. Edhe pse ligji nuk percakton asni me vlera kufi maksimum ose minimum ne lidhje me detyrimin e pashlyer, gjykata cmon se ne rastin konkret vlera prej 90.918.696 lekesh perfason nje shume te konsiderueshme per vjeljen e se ciles mund te iniciohet edhe nje procedure falimentimi

Nga provat e marra ne gjykim rezulton qe te gjitha aktet administrative qe kane vendosur detyrime financiare per debitorin i jane njoftuar atij, megjithate ai nuk e ka permbushur detyrimin. Te gjitha detyrimet e shoqerise jane te maturuara sipas afateve te parashikuara ne dispozitat e ligjit «Per Procedurat Tatimore», gje e cila e ka detyruar organin tatimor te aplikoje gjobat si dhe te nxjerre urdher sekuestrimi te pasurise, urdher per bllokimin e aktivitetit, udher per bllokimin e llogarise bankare etj.

Njoftimi i vleresimit te pare tatimor i papermbushur jane te dates 25.04.2002; 05.07.2004; tatim fitimi paraprak per vitin 2002, 2004, 2005; etj. Rrjedhimisht debitori eshte ne vonese per me shume se tre muaj nga dita e maturimit per cdo detyrim te tij.

Nga ana tjeter, nga provat e marra ne gjykim nuk rezulton te kete reklamime, kundeshtime, apo hapje te ndonje procesi gjyqesor nga ana e debitorit per kontrollet e ushtruara nga Dega.

"Nga gjithe analiza e mesiperme Gjykata e Falimentimit cmon se kerkuesi, Dega e Tatimpaguesve te Medhenj, legjitimohet per te kerkuar hapjen e procedures se falimentimit,

sepse si kreditore e shoqerise "Hawai Alb" shpk, ajo ka interes te ligjshem dhe shkaqet jane te mjaftueshme dhe bindese."

1. Ne vazhdim te gjykimit, ne respektim te dispozitave ligjore dhe te rolit te saj aktiv, gjykata mori keto vendime te ndermjetme:

- Ne zbatim te nenit 17/2 te ligjit dhe 193 te K. Pr. Civile (dispozitat e K. Pr. Civile zbatohen ne kete gjykim per aq sa nuk bien ne kundeshtim me ligjin e posacem) vendosi te therrase ne gjykim me cilesine e personit te trete shoqerine tregtare "Hawai alb" shpk.
- Ne zbatim te nenit 21 pika 2/a te ligjit Gjykata pajisi me dokumentacionin e duhur Administratorin e Perkohshem te Falimentit sic ishin vertetimet me nr 2556 akti dt 09.06.2006, drejtar Zyres Qendrore te Pasurive te Paluajtshme Tirane;
- Vertetimi nr 2556 akti dt 09.06.2006 drejtar Bankave te nivelit te dyte ne RSH,

Ne zbatim te nenit 6/2 dhe te nenit 18 te ligjtit emeroi z. Berti Pashko, ekspert kontabel te autorizuar, anetar te IEAK-as, me Nr. 7 license si Administrator te Perkohshem te Falimentimit.

Ne caktimin Administratorit te Perkohshem te Falimentimit Gjykata mori parasysh njohurite e tij te posacme ne lidhje me detyren qe iu ngarkua si dhe faktin qe ai nuk kishte lidhje me asnje nga subjektet qe perfshiheshin ne kete procedure falimentimi.

Administratorit te Perkohshem te Falimentimit iu ngarkuan keto detyra te cilat gjeten zgjidhjet e meposhtme (neni 18 i ligjit):

- 1. Te verifikoje nese eshte real shkaku per hapjen e procedures se falimentimit.**
- 2. Te verifikoje nese pasurite e debitorit mjaftojne per te mbuluar shpenzimet e falimentimit.**
- 3. Te verifikoje nese eshte e nevojshme te merren masa per sigurimin e pasurise.**
- 4. Te verifikoje nese eshte mundesia per vazhdimin e veprimitarise se debitorit.**

Ne zbatim te ketyre detyrate te ngarkuara nga Gjykata e Falimentimit Administratori I Perkohshem I Falimentimit sqaron:

Nga per gjigjet e marra nga Zyra Qendrore e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane dhe ato te rretheve te Shqiperise, rezulton se vetem ne dy rrethe, sakesisht ne Tirane dhe Durres, rezultojne qe kjo shoqeri zoteron keto prona:

- A) Sipas shkreses me nr 4445/1 dt 09.06.2007 ZVRPP Tirane konfirmon se:

"Nga te dhenat e sistemit dixhital, I cili nuk perfshin rregjistrimin e pasurive te paluajtshme ne zonen rurale te qytetit te Tiranes, ne emer te shoqerise "HAWAI – ALB" shpk figuron e rregjistruar nje truall me siperfaqe 5000 m² se bashku me e gjitha investimet e bera mbi kete truall, te ndodhur ne rrugen "Kongresi I Permetit", I rregjistruar me nr hipotekar 27, dt 31.10.2002, Zona Kadastrale 8210."

- B) Sipas shkreses me nr 1044/1 dt 01.06.2007, ZVRPP Durres konfirmon se:

"Prona ne emer te shoqerise "HAWAI – ALB" shpk eshte rregjistruar ne n. hipotekar 358, dt 17.04.2001 ne Zonen e Kadastrave 8518. Prona eshte pallat me 133 apartamente, nje bar restorant dhe dy ambjente sherbimi. Kjo prone ne regjistrat e kesaj zyre jane rregjistruar gjithesej 65 shitje ne emer te te treteve, ndersa 26 apartamente jane shkembyer me pronaret e truallit."

- C) Ne per gjigjet e shkresave nga ZVRPP te rretheve te tjera te Shqiperise nuk rezultojne te kete prona te regjistruar ne emer te shoqerise "HAWAI ALB" shpk.

...
3) Ne total per pronen ne Tirane vlera e truallit me siperfaqe 5000 m² se bashku me investimet arrin ne shumen 2,020,000 euro.

...
8) Ne total pasuria qe eshte ne pronesi ne rrethin e Durresit eshte e barabarte me 1,236,000 euro.

Pra vlera e pasurise se shoqerise tregtare "HAWAI ALB" shpk arrin nje shume prej 3,256,000 euro (1,236,000 euro + 2,020,000 euro). Nisur nga fakti qe borxhi I shoqerise "HAWAI ALB" shpk ndaj Deges se Tatimpaguesve te Medhenj Tirane eshte per shumen 90,918,696 leke, afersisht 740,000 euro, atehere arrijme ne konkluzionin se kjo pasuri e mbulon kete borxh (fq 2-3 e aktit te Administratorit te Perkozhshem te Falimentimit).

1. A egziston shkaku ligjor per te hapur nje procedure falimentimi ndaj shoqerise "Hawai Alb" shpk ?

Per fillimin e nje procedure falimentimi, ligji parashikon nevojen e ekzistences se nje shkaku. Neni 13 i ligjit parashikon tre shkaqe:

1. gjendja e paaftesise paguese te debitorit
2. paaftesia paguese ne nje te ardhme te afert, qe mund te pretendohet si shkak vetem kur iniciues i procedures se falimentimit eshte vete debitori dhe
3. mbingarkesa me borxhe ne rastin kur debitor eshte nje personi juridik.

Duke iu referuar perqigjes se detyrave te ngarkuara Administratorit te Perkohshem te Falimentimit, te dhenave te bankave dhe Zyres Qendrore te Regjistrimit Pasurive te Paluajtshme, si dhe duke marre ne konsiderate vleren e perqijethshme te debise se tij, Gjykata konkludon se pasurite e shoqerise "Hawai Alb" shpk jane te mjaftueshme per te mbuluar detyrimet e saj dhe se nuk ka mundesi te vazhdohet veprimitaria e saj. Kjo gje nuk do te ndryshonte fare kete debitor edhe ne dinamiken e tij. Edhe pse ne kushtet kur ka mungese te dhenash qe prej vitit 2004 per bilancin e shoqerise debitore, lidhur me aktivin dhe pasivin e tij, per ta patur me te lehte konstatimin e nje mbingarkese me borxhe, Gjykata cmon se ne gjendjen financiare qe eshte kjo shoqeri, nuk ka asnje mundesi apo parashikim pozitiv per te ardhmen e saj.

Ne keto kushte gjykata cmon se ekziston shkaku ligor i mbingarkeses me borxhe sipas nenit 13 parag 4 i ligjt «Per falimentimin».

2. A mjafton pasuria e debitorit per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit?

Nga rapporti i Administratorit te Perkohshem te Falimentimit rezultoi gjithash tu se pasuria e debitorit eshte e mjaftueshme per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit, shpenzime qe perbehen nga: shpenzime gjyquesore, pagesa e Administratorit te Perkohshem te Falimentimit gjate fazave te tjera te procedures, nga shpenzimet e komitetit te kreditoreve, te Administratorit te Falimentimit etj.

Ka rezultuar ashtu sikunder u permend me lart se:

Ne pronesi te debitorit, eshte pasuria "truall" me siperfaqe 5000 m² se bashku me investimet e bera mbi kete truall te ndodhura ne Zonen Kadastrale 8210, me nr hipotekor 27 dhe dt 31.01.2002 ne rrugen "Kongresi I Permetit", ne Tirane.

Po keshtu konform perqigjes se ardhur nga Zyra e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Vendore Durres, ne emer te "Hawai Alb" shpk eshte e rregjistruar me nr hipotekor 358 dt 17.04.2001 ne Zonen Kadastrale 8518 ne Durres prona pallat me 133 apartamente, nje bar restorant dhe dy ambjente sherbimi.

Po keshtu nga shkresa me nr 1044/1 dt 01.06.2007 e kesaj Zyre rezulton se nga keto apartamente jane rregjistruar gjithsej 65 shitje ne emer te te treteve,

ndersa 26 apartamente jane shkembyer me pronaret e truallit. Ky fakt u konfirmua edhe me shkresat nr 1737/4 Prot dt 11.06.2007 e Zyres Qendrore te Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane si dhe shkresa me nr 4445/1 dt 09.06.2007 te Zyres Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Vendore Tirane dhe shkresa me nr 1044/1 dt 01.06.2007 te Zyres se Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Vendore Durres.

Kerkuesit kerkuan dhe marrjen e mases se sigurimit gjate gjykimit mbi bllokimin e ketyre pasurive (sekuestrimin e tyre).

Gjykata e gjeti kerkesen te mbeshtetur ne nenin 21 te ligjit nr 8901 dt 23.05.2002 ne te cilen sanksionohet se:

“...Derisa seksioni tregtar I Gjykates se Rrethit te marre vendim per kerkesen per hapje te procedures se falimentimit, ai vendos mbi pasurite e debitorit cdo lloj mase qe e gjykon te nevojshme per te shhangur perkeqesimin e gjendjes financiare te debitorit si dhe te kreditoreve.

Ndaj me vendimin e dt 12.06.2007 Gjykata vendosi konform kesaj dispozite sekuestron konservative (bllokimin) e te gjitha veprimeve juridike mbi keto pasuti

Neni 26 i ligjit parashikon:

“Seksioni tregtar i Gjykates se rrethit vendos hapjen e procedures se falimentimit kur cmon se jane shkaqet dhe kushtet e tjera te parashikuara ne kete ligj per hapjen e procedures se falimentimit.”

Duke u bazuar ne raportin e Administratorit te Perkohshem te Falimentimit, ne provat e sjella nga kerkuesi dhe te marra ne gjykim, te dhenat e 16 bankave dhe te Zyres Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane e Durres Gjykata cmon se **se pasuria e debitorit eshte e mjaftueshme per mbulimin e shpenzimeve te falimentimit.**

Gjykata ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor cmon se ka vend per pranimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit kjo edhe konform edhe nenit 26 e vijues e ligjit nr 8901 dt 23.05.2002.

Kreditoret e shoqerise duhet qe brenda afatit 90 ditor te paraqesin tek Administratori I Falimentit z. B.Pashko pretendimet e tyre sipas nenit 141 te ligjit nr 8901 “Per falimentimin” dt 23.05.2002.

Ne kete dispozite parashikohet se:

“1. Kreditoret e falimentimit duhet t’ia paraqesin me shkrim pretendimet e tyre administratorit te falimentimit. Njostimi duhet t’I bashkelidhet nje kopje e dokumentave qe provojne pretendimin.

2. Kerkesa duhet te perfshije arsyen, shumen e pretendimit, si dhe te permende radhen sipas nenit 605 te Kodit Civil.

3. Kerkesa e rangjeve me te ulta paraqesin pretendimet te tyre vetem nese seksioni tregtar I gjykates se rrethit e kerkon posaçerisht kete gje.”

Po keshtu te gjithe personat te cilet kane detyrime ndaj debitorit duhet t'a paguajne ato dhe t'ia shlyejne Administratorit te Falimentimit.

Gjykata cakton si afat te nevojshem per zhvillimin e mbledhjes se kreditoreve afatin 45 dite nga shpallja e vendimit dhe ne cdo rast jo me shume se 90 dite, si dhe mbledhja per verifikim te kreditoreve brenda afateve te percaktuara ne nenin 28 te ligjit.

Ne perfundim Gjykata si respektoi me korektesi te gjitha kerkesat e legjislacionit procedural civil konkludon ne pranimin e kerkeses.

PER KETO ARSYE

Konform nenit 26 te Ligjit nr 8901 dt 23.05.2002 "Per Falimentimin"

VENDOSI

- Pranimin e kerkeses.
- Hapjen e procedures se falimentimit per shoqerine tregtare "Hawai Alb" shpk regjistruar si person juridik me vendimin nr 16807 dt 28.01.1997 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne Tirane, Qendra e Biznesit "Veve Center", me objekt te veprimtarise: import-eksport mallrash, investime ne fusha te ndryshme si ate te ndertimeve publike, te godinave te banimit, te infrastructures, ne blerje e shitje trojesh dhe dhenie me qira e tyre dhe e ndertesave; investime ne fushen e turizmit si aktivitete turistike, celje restorantesh dhe hotelesh, camping dhe fshatra turistike, axhensi turistike; investime ne fushen e transportit si transportin detar, automobilistik, ajror; ndertime civile, sociale dhe ekonomike, ndertim rrugesh, ujesjelles e kanalizime, sipermarrje; prodhim dhe tregtim materialesh inerte, me administrator Elsayed Metwally Abdelrahman.
- Caktimin me detyren e Administratorit te Falimentimit per shoqerine tregtare "Hawai Alb" shpk ekspertin kontabel te autorizuar z. Berti Pashko, banues ne Tirane, Bulevardi "At Gjergj Fishta", pall E 88 nr 12, me nr license 07 dt 10.02.2000.
- Urdherohet publikimi I ketij vendimi konform nenit 9 dhe 29 te Ligjit nr 8901 dt 23.05.2002 "Per falimentimin".
- Ligjerimin e mases se sigurimit dt 12.06.2007.
- Kopje e ketij vendimi t'I dergohet Zyres se Rregjistrat Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane si dhe Zyres se Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane dhe Durres.
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te personit te trete.

- Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykaten e Apelit Tiranë, per kerkuesin ky afat fillon nga dita e shpalljes se vendimit, ndersa per personin e trete ne mungese, ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni.

Tiranë, me 20.07.2007 ora 12.30

SEKRETARE
ELONA ALVORA

GJYQTARE
REGLETA PANAJOTI

Shpenzime gjyqesore:
Shpenzime per Administratorin e Perkohshem te Falimentimit – 216.000 leke